



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr. 24, datë 27/07 /2016

PROPOZIM PËR PËRFITIM PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 27/07/2016 në zbatim të Ligjit Nr.139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, neni 5, (i ndryshuar), VKM- së Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme”, pika 4 dhe 5, kërkesës së Shoqatës së Volejbollit “Flamurtari”, Bashkia Vlorë si dhe kërkesës së z. Theodhori DRIZA,

Vendosi;

Ti propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhënien e Pensionit të Posaçëm Shtetëror **Zotit Theodhori Rako DRIZA** për rezultate të dallueshme në fushën e sportit.



**Kryetari i Këshillit të Qarkut
Sadrit DANAJ**